



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

TEPELENË

Nr :1917/3Prot

Tepelenë, më,01.09.2022

V E N D I M

NR .67.DATE 31.08.2022

**“PËR MIRATIMIN E INDIVIDËVE/FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI“SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË,SIPAS PROJEKTIT TË BASHKISË TEPELENË”**

Ne mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nenpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit m. 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore", ligjit nr. 22/2018 "Per strehimin social", vendimit nr. 35date 28.04.2022, "Per miratimin dhe zbatimin e programit social te strehimit subencionimit te interesave te kredisë, hartuar siaps udhëzuesit operacional”, marrëveshjes mbi kreditimin nga RBAL të nevojave për strehim të të pastrehëve sipas projektit të bashkisë nr2381prot datë 06.12.2021 si dhe në vijim të Relacionit të Komisionit të Strehimit.

V E N D O S I

1. Miratimin e listës së individëve/familjeve që përfitojnë nga programi social “Subvencionimi I Interesave të Kredisë” , sipas aneksit nr1 bashkelidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- 2.Indivdët/familjet e përcaktuara në Aneksin nr1 të këtij vendimi ,të paraqiten pranë institucionit banker, brenda 6(gjashtë) muajve nga momenti I njoftimit të këtij vendimi.
- 3.Pavarsisht parashikimeve të pikes 2 , në rastet kur individi /familja nuk gjejnë banesë brenda 6(gjashtë) muajve nga momenti I njoftimit, të paraqiten pranë institucionit financiar,si dhe Bashkisë Tepelenë, përpara përfundimit të këtij afati ,duke kërkuar shtyrjen e tij edhe me 6 muaj të tjerë.Mosrespektimi I këtij afati përbën shkak për skualifikimn e tyre.
4. Drejtoria Ligjore pas ezaurimit të procedurave të parashikuara në këtë vendim të dërgojë pranë institucioneve financiare me të cilat është nënshkruar marrëveshja, listat e përfituesve.

5. Ngarkohen Drejtoria Ligjore dhe Shërbimet Organizative dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Gjirokastrë.

**KRYETAR**

**Elvis Shehu**

Sekretari I Këshillit Bashkiak  
Valbona Çela

Miratuar me 12( dymbëdhjetë) vota

Vota Pro 12( dymbëdhjetë)

Vot a Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 01.09.2022.